



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:088211
Datë: 11.03.2024
Numri i dokumentit: 05474794

Ac.nr.5380/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B. B. nga Suhareka, të cilën me autorizim e përfaqëson B. M., avokat me seli në rr. “Remzi Ademi”, nr... nga Prizreni, kundër të paditurës, Komuna e Suharekës, Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti kthim në vendin e punës dhe kompensimin e pagave, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.299/2020, të datës 13.07.2022, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 11.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e paditëses B. B. nga Suhareka, **PRISHET** Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.299/2020, i datës 13.07.2022 dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar, C.nr.299/2020, të datës 13.07.2022 ka vendosur si në vijim: “Padia e paditëses B. B. nga Suhareka, përfaqësuar nga av. B. M. nga Prizreni, e paraqitur në këtë gjykatë më 27.7.2020, ndaj të paditurës, Komuna e Suharekës, Drejtoria e Arsimit, për shkak të kthimit në vendin e punës dhe kompensimin e pagave, hedhet poshtë si e palejuar për shkak të litispidencës.

Kundër këtij aktvendimi paditësja, përmes përfaqësuesit të saj brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke argumentuar se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktvendimit të ankimuar nuk ka dhënë arsye bindëse për faktet vendimtare siç nuk ka bërë asnjë analizë lidhur me provat e vlerësuara dhe të administruara dhe nuk ka arsyetuar se në cilat prova është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështje. I ka propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës që ankesën e të njëjtës ta aprovojë si të bazuar ndërsa aktvendimin e ankimuar ta anulojë ashtu që çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Nga shkresat e lëndës, konstatohet se e paditura e ka pranuar ankesën e paraqitur nga pala paditëse me datë 09.08.2022 derisa e njëjta nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesat e paditëses është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja B. B. nga Prizreni, me datë 27.07.2020, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, kundër të paditurës, për kthim në vendin e punës dhe kompensimin e pagave, me pretendimet se e njëjta ka punuar tek e paditura në shkollë të ndryshme dhe ka gjithsej shtatë vite përvojë pune. Drejtoria Komunale për Arsim në Suharekë me anë të Vendimit 05 Nr.865, të datës 03.09.2019 e ka transferuar si zëvendësim të njëjtën nga SHMT "Skender Luarasi" në SHMP "Abdyl Ramaj" në Shirokë deri më datë 31.12.2019. Ndaj këtij vendim paditësja ka paraqitur ankesë mirëpo meqenëse e paditura e kishte refuzuar ankesën e paditëses, e njëjta i është drejtuar Inspektoratit të Punës me ankesë dhe me anë të Vendimit Nr.1172/19, të datës 15.11.2019 e paditura është obliguar që me paditësen të lidh kontratë pune me afat të pacaktuar. E paditura edhe përkundër këtij vendimi me paditësen kishte lidhur kontratë pune me afat të caktuar deri në kthimin në vendin e punës të një mësimdhënëseje e cila gjendej në pushim të lehonisë dhe po ashtu të njëjtës nuk i kishte paguar pagat për muajin prill dhe maj 2020. Me këto veprime, paditësja konsideron se e paditura i ka shkelur të drejtat e punës andaj përmes padisë ka kërkuar që të detyrohet e njëjta që paditësen ta kthejë në vendin e punës si mësimdhënëse në SHMT "Skender Luarasi" në Suharekë me kontratë me afat të pacaktuar dhe t'ia kompensojë të ardhurat personale.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas mbajtjes së shqyrtimit përgatitor më datë 29.06.2022, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar C.nr.299/2020, të datës 13.07.2022, me të cilin e ka hedhur poshtë si të palejuar padinë e paditëses për shkak të litispedencës.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë deri të vendosja si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar ka theksuar se ka ardhur ngase për çështjen e ngritur me padi ekziston gjyqëvarësia. Faktin e gjyqëvarësisë gjykata e bazon në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, respektivisht të bashkëlidhura padisë, dhe atë në vendimin Nr. 1172/2019, datë 15.11.2019, i vërtetuar me vendimin Nr. 01-110-70124, datë 9.10.2019, që kreditores, këtu palës paditëse i ka shërbyer si dokument përmbarimor në procedurën përmbarimore me qëllim të realizimit të dhunshëm të të drejtës subjektive pretenduese, tani të paraqitur në këtë proces gjyqësor. Për mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitave ligjore nga neni 391, paragrafi 1, pika a) të LPK-së.

Pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Apelit të Kosovës nuk mund t'i pranojë si të rregullta dhe të ligjshme, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje të qarta të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 e lidhur me nenin 262 dhe nenin 391 pika a) dhe pika c) të LPK-së. Gjithashtu aktvendimi i shkallës së parë ka mungesë të theksuar të arsyetimit sipas nenit 173 të LPK-së.

Deri të shkelja e dispozitave të cituara ka ardhur për arsye se gjykata e shkallës së parë i ka interpretuar dhe zbatuar gabimisht, përkatësisht nuk i ka zbatuar fare dispozitat e neneve të sipërcituara. Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore konsiston në faktin se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar dispozitat nga neni 391 par.1 pika a) të LPK-së, kur ka konsideruar se për çështjen e ngritur me padi ekziston gjyqëvarësia, kjo pasi që e paditura gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 29.06.2022 ka deklaruar se për të njëjtin kontest është duke u zhvilluar edhe procedura përmbarimore, mirëpo kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me gjyqvarësi, ngase gjyqvarësia ekziston në rastin kur kemi të bëjmë me dy çështje juridike në zhvillim e sipër sipas procedurës kontestimore dhe jo në stadin e procedurës përmbarimore, siç është rasti konkret.

Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i paqartë, arsyet e paraqitura janë kundërthënëse dhe në mënyrën se si janë paraqitur është vështirë të kuptohet se cili ka qenë qëllimi i vendosjes në këtë mënyrë nga gjykata e shkallës së parë. Gjykata ka ngatërruar institutin e Litispidencës, ngase me provat ekzistuese nuk është vërtetuar se mes palëve të njëjta dhe për çështjen e njëjtë është duke u zhvilluar ndonjë proces tjetër kontestimor. Me dispozitat ligjore nga 262 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, shprehimisht parashihet se: *“Gjyqvarësia krijohet që në momentin në të cilin të paditurit i dorëzohet padia”* dhe *“Sa i përket kërkesës të cilën pala e ka parashtruar gjatë zhvillimit të procedurës, gjyqëvarësia krijohet në momentin në të cilin është njoftuar pala kundërshtarë për kërkesën e tillë”*. Nga aktvendimi CP.nr.12/20, i datës 07.09.2020, të cilin e paditura e ka prezantuar si provë në shkresa të lëndës, në procedurën përmbarimore është lënë në fuqi Aktvendimi E.nr.12/20, i datës 14.07.2020 dhe është urdhëruar pala debitore, këtu e paditura që ta zbatojë Vendimin e Inspektoratit të Punës Nr.1172/2019, të datës 15.11.2019 për kthim në punë. Injektiviteti vendim nuk ka të bëjë edhe me kërkesën tjetër të paraqitur në padinë e paditëses lidhur me kompensimin e pagave. Sido që të jetë, litispidenca nuk mund të krijohet në situata kur për të njëjtën çështje, inicohet procedurë përmbarimore, apo pala ka një vendim të dhënë nga një organ administrativ, prandaj mbi bazën e të gjitha këtyre arsyeve, kjo gjykatë arrin në përfundimin se në këtë çështje nuk bëhet fjalë për gjyqvarësi.

Gjykata e Apelit të Kosovës, vlerëson se po ashtu me të drejtë qëndrojnë edhe pretendimet ankimore të paditëses kur ka theksuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka shqyrtuar fare kërkesën e saj në raport me pagat e papaguara, ngase ajo kishte kërkesë edhe për këtë pjesë.

Andaj, udhëzohet gjykata e shkallës së parë që në ri procedurë të veprojë në pajtim me dispozitat e LPK-së, së pari, të ndërmerr veprime në drejtim të qartësimit nëse pala ka një padi tjetër në gjykatë me objekt të njëjtë kontesti dhe palë të njëjta, në atë mënyrë që çështja e litispidencës do të konsumohet dhe nuk do të kishte dilema. Së dyti, nëse nuk ka padi tjetër të paraqitur nga pala paditëse, gjykata e shkallës së parë udhëzohet të ndërmerr veprime në drejtim të qartësimit të kërkesave të palës, në atë mënyrë që të dihet saktësisht çështja kontestuese që është ngritur, duke përfshirë kërkesat kryesore përfshirë periudhën kur kërkohen, po ashtu kërkesat aksesore nëse eventualisht parashtrohen. Më pas nëse plotësohen kushtet ligjore për vendosjen meritore të çështjes kontestuese, atëherë me rastin e përpilimit të aktgjykimit t'i ketë parasysh kërkesat ligjore që rrjedhin nga dispozitat e nenit 160 të LPK-së, ashtu që pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse,

të vërtetojë gjendjen faktike, bazën juridike dhe në fund të vendosë për kërkesëpadinë e paditësit.

Nga të cekurat me lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 pika (d) e LPK-së, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.5381/2022, me datë 11.03.2024

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari
Dardan Kadolli